

SONILA BOÇI**PARTIA E PUNËS SË SHQIPËRISË NË KËRKIM TË NJË
QENDRE GRAVITACIONI PËR GRUPET MARKSISTE-
LENINISTE NË ITALI
(1963-1966)**

Vitet që pasuan prishjen e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik, shënuan tensionim të ndjeshëm të marrëdhënieve mes Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) dhe partive komuniste dhe punëtore në Botë e, midis tyre edhe me Partinë Komuniste të Italisë (PKI). Në të vërtetë, pakënaqësitë mes PPSH-së dhe PKI-së kishin filluar që prej vitit 1957, kur sekretari i Përgjithshëm, Palmiro Togliatti prezantoi në Kongresin VII, tezati mbi “rrugën italiane për në socializëm”. Pas Mbledhjes së 81 partive Komuniste dhe Punëtore të mbajtur në Moskë, ku Enver Hoxha shpali hapur qëndrimin e PPSH për vijën politike të Nikita Hrushovit, konflikti doli hapur në sipërfaqe.

Në fillim të vitit 1963, ishte e qartë se ndërmjet PKI-së dhe PPSH-së nuk ekzistonte vullneti i mjaftueshëm për t'i sheshuar kontradiktat. Tashmë rrugët ishin ndarë. Në Kongresin X të PKI-së (dhjetor 1962), si drejtuesit e saj, ashtu edhe pjesa më e madhe e të ftuarve nga partitë e tjera komuniste, përveç Partisë Komuniste të Kinës (PKK), nuk i kursyen etiketimet “dogmatikë, sektarë, prishës të unitetit, aventurierë” për krerët e PPSH-së. Ndërsa u treguan më të kujdesshëm ndaj sulmeve të drejtpërdrejta për Kinën e Maos, ajo sërish u kritikua sepse vazhdonte të merrte në mbrojtje udhëheqjen intransigjente shqiptare¹. Por, edhe drejtuesit e lartë të PPSH-së nuk e fshehën qëndrimin e tyre aspak miqësor ndaj lidërshiptit të PKI-së. Telegrami i përshëndetjes që i drejtohej Kongresit X ishte në fakt një thirrje për komunistët italianë për

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i PPSH (më tej: AP)-stukturat (më tej: str.), Viti (më tej: V.) 1962, Dosja (më tej: D.) 559, fl. 35. Informacion i legatës shqiptare në Romë mbi zhvillimin e Kongresit X të PKI. PKK deri më 1964 ishte treguar e kujdesshme në artikullimin publik të kontradiktave të saj me PK të BS. Drejtuesit komunistë kinezë përdornin një gjuhë të kujdesshme dhe mjaft diplomatike kur shpalosnin qëndrimin e tyre, ndryshe nga udhëheqësit e PPSH, të cilët ishin mjaft të ashpër dhe nuk linin asnjë shteg për kompromis.

t'iu bashkuar rrugës revolucionare në mbrojtje të marksizëm-leninizmit. Ndërsa nuk përmendte asnjëherë udhëheqjen e PKI-së, me një gjuhë disi më diplomatike, ai veçonte anëtarësinë e saj, duke shprehur simpatinë për luftën e komunistëve italianë kundër shfrytëzimit kapitalist, për mbrojtjen e interesave të klasës punëtore dhe të masave punonjëse dhe zgjerimin e lirive demokratike, për pavarësinë e vendit kundër politikës së nënshtrimit ndaj imperializmit amerikan e NATO-s dhe shndërrimit të Italisë në një bazë armësh atomike e raketash. Telegrami mbyllet me urimet për suksese “në **luftën revolucionare** [nënvizimi im - S.B.] për triumfin e socializmit në Itali, për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, kundër pikëpamjeve e veprimeve përçarëse të revizionistëve modernë, për zbatimin e parimeve të Deklaratave të Moskës të viteve 1957 e 1960”².

Qartazi grupet marksiste-leniniste, të krijuara apo në proces krijimi në Itali, motivoheshin dhe mbështeteshin në pikëpamjet e Kinës së Mao Ce Dunit. Për një pjesë të madhe të komunistëve revolucionarë italianë, PPSH-ja ishte një ndërmjetëse ndërmjet tyre dhe Kinës. Edhe për mbështetësit më të zjarrtë të Shqipërisë ndër radhët e komunistëve italianë, PPSH-ja ishte një parti e re (shumë më e re sesa PKI-ja), e cila drejtonte një vend të vogël dhe të varfër. Megjithatë, një pjesë e tyre ishin të frymëzuar dhe të impresionuar nga guximi i Hoxhës në përballje me Hrushovin.

Por, kjo nuk ishte mënyra se si e shihte Enver Hoxha veten dhe PPSH-në në këtë situatë. Nëse do të analizosh dokumentet e arkivave shqiptare midis viteve 1963-1965, para formimit të PKI (m-1)^{*}, E. Hoxha e vendos veten më shumë në rolin e një mentori, i cili dëshiron t'u tregojë komunistëve evropianë, mes tyre edhe atyre italianë, rrugën drejt bashkimit dhe vlerave të vërteta të marksizëm-leninizmit. Në një plan më praktik, ai kërkonte t'i shfrytëzonte këto grupe për të propaganduar “sukseset e shqiptarëve në ndërtimin e socializmit” duke krijuar kështu imazhin e duhur për Shqipërinë, në Itali dhe më gjerë.

Legata shqiptare në Romë, sipas udhëzimeve të detajuara që i vinin nga Komiteti Qendror (KQ) i PPSH-së, e ndiqte me kujdes dhe në

² *Po aty*, F. 14/AP-Marrëdhëniet me PKI (më tej: MPKI), V. 1962, D. 3, fl. 1. Telegram urimi i PPSH për Kongresin X të PKI, 5 dhjetor 1962.

^{*} *Partia Komuniste e Italisë* (m-1) u krijua në Livorno, më 15 tetor 1966.

vijimësi çdo lloj zhvillimi brenda lëvizjes komuniste italiane. Në fillim të vitit 1963, ajo shprehej optimiste për situatën shumë të favorshme që ekzistonte në Itali për zhvillimin e luftës kundër revizionizmit. Optimizmi i ministrit shqiptar në Romë, Jordan Pani bazohej: në perceptimin se shumë nga komunistët e vjetër, sidomos punëtorë dhe fshatarë, ishin në opozitë me udhëheqjen aktuale; në të dhënat se brenda lidhshpimit të PKI-së nuk kishte unitet dhe “secili përpiqej të ruante pozitën e tij”; në faktin se në të gjithë Italinë ishin krijuar grupe komunistësh që “kundërshtonin revizionizmin dhe përpiqen të organizojnë luftën politike dhe ideologjike kundër tij”; dhe, së fundi, në interesin e vazhdueshëm për materialet ideologjike që boton “partia jonë dhe Partia Komuniste e Kinës”³. Kjo situatë optimiste ftonte drejtuesit e lartë të PPSH-së të ndryshonin strategjinë në lidhje me punën që duhet të kryenin në gjirin e lëvizjes komuniste në Itali. “Tashmë në Itali, - shkruante J. Pani, - janë krijuar kushte të tilla për punë që të mos varen shpresat vetëm në komunistë të vjetër si Secchia, Terracini, Colombo, Vidali, D’Onofrio⁴, të cilët duket se nuk aktivizohen, por ka komunistë të bazës dhe kuadro të tjera tek të cilët mund të mbështetemi në punën tonë”⁵.

Informacioni që ministri shqiptar jepte mbi grupet komuniste të shkëputura nga PKI-ja është disi sipërfaqësor dhe duket se ai ende nuk ka krijuar një ide të qartë mbi karakterin e këtyre grupeve. Gjithsesi, ai informon eprorët e tij se disa prej këtyre grupeve, si ai i Padovës, apo komunistët e Romës kanë kontaktuar legatën shqiptare. Disa prej tyre, siç ishte rasti i komunistëve të Romës, të cilët nuk përbënin një grup të formuar, kishin kërkuar ndihmë për sigurimin e më shumë materialeve të PKK-së dhe këshilla mbi strategjinë e punës së tyre dhe pikërisht mbi nëse “duhet të dilnin si mbrojtës të kinezëve dhe shqiptarëve, apo të

³ AQSH, F. 14/AP-str., V. 1963, D. 636, fl. 1. Relacion i Piro Bitës për drejtuesit e KQ të PPSH mbi disa çështje lidhur me Partinë Komuniste të Italisë, 16 shkurt 1963.

⁴ Të përmendurit janë anëtarë të strukturave të larta drejtuese të PKI, komunistë të vjetër dhe anëtarë të parlamentit italian. Shumica e tyre nuk kishin përkrahur tezën e Palmiro Togliatti-t në Kongresin VII të PKI, por, me përjashtim të Secchia-s, nuk kishin treguar entuziazëm për qëndrimin e PKK apo të PPSH në mbledhjen e Moskës.

⁵ Po aty, F. 14/AP-str., V. 1963, D. 636, fl. 1. Relacion i Piro Bitës për drejtuesit e KQ të PPSH mbi disa çështje lidhur me Partinë Komuniste të Italisë, 16 shkurt 1963.

kufizoheshin vetëm në luftën kundër oportunitizmit dhe revizionizmit të vijës italiane”⁶.

Por, ndërsa komunistët e Romës kërkonin më shumë materiale të PKK-së, porosia që i vjen Jordan Panit nga Tirana ishte: “Shoku Jordan duhet të mbajë parasysh më shumë këto dy çështje: a) të punojë që të rritet shumë më tepër numri i të njohurve dhe i miqve të Shqipërisë sidomos midis komunistëve, por edhe njerëzve të tjerë përparimtarë. ... b) të mos shkojë vetë në çdo takim me çfarëdo njerëzish, të ruajë prestigjin e përfaqësuesit të RPSH”⁷.

Shtimi i grupeve, të cilat kishin dalë në opozitë të hapur me PKI-në, nxiti interesin e drejtuesve të lartë të PPSH-së, të angazhuar tashmë në një fushatë ndërkombëtare për të organizuar e mbështetur grupet marksiste-leniniste dhe për të mësuar më shumë rreth tyre. Në këtë mënyrë ata do të mund të adaptonin një strategji për t’u përshtatur me këtë situatë të re. Në mars 1963, Hysni Kapo i dërgoi një letër Jordan Panit, në të cilën i kërkonte informacion të detajuar mbi tri çështje kryesore: mbi zhvillimet brenda PKI-së; mbi jehonën që kishin bërë në masën e gjerë të komunistëve italianë artikujt e botuar në shtypin kinez dhe shqiptar kundër revizionizmit; si dhe mbi zhvillimet në lëvizjen revolucionare në Itali. Në lidhje me këtë, Hysni Kapo kërkon që informacioni të përqendrohet specifikisht mbi të kuptuarit se “cilat janë vështirësitë me të cilat ndeshen tani komunistët italianë, në ç’drejtim u duhet dhënë ndihmë atyre, çfarë mund të bëhet për të inkurajuar dhe ndihmuar luftën e tyre kundër revizionizmit”⁸.

Relacioni që pasoi letrën e Hysni Kapos ndryshonte shumë nga ai i fillimit të vitit 1963 dhe duket se ishte më i studiuar dhe më i kujdesshëm në mbledhjen e të dhënave. Sa i takon situatës së përgjithshme brenda PKI-së, ministri shqiptar e kishte humbur entuziazmin e katër muajve më parë dhe ishte i detyruar të pranonte se fjalimi përmbyllës i P. Togliattit në Kongresin X, i cili u ishte kundërpërgjigjur akuzave të PKK-së mbi gabimet në “rrugën italiane për në socializëm” kishte bërë përshtypje shumë të mirë në masën e gjerë të komunistëve italianë, të cilët tashmë ishin të bindur se PKK-ja dhe PPSH-ja nuk e njihnin sa duhet situatën e brendshme të Italisë⁹.

⁶ *Po aty*, fl. 4.

⁷ *Po aty*, fl. 5.

⁸ *Po aty*, fl. 8-9. Letër e Hysni Kapos për Jordan Panin, 15 mars 1963.

⁹ *Po aty*, fl. 12. Relacion mbi gjendjen në PKI, mars 1963.

Relacioni i përfaqësuesit diplomatik shqiptar jep të dhëna mjaft interesante, të cilat na ndihmojnë për të kuptuar perceptimin e komunistëve shqiptarë mbi grupet e komunistëve italianë në opozitë me PKI-në. Jordan Pani relatonte se kishte një konfuzion të madh në opozitën e komunistëve italianë kundër PKI-së. Në shumësinë e grupeve të krijuara kishte trockistë, buharianistë dhe grupe të tjera në pozita aspak revolucionare. Për të, grupet që deri-diku ishin në pozita revolucionare, Pani rreshtonte grupin e Padovës, Milanos, Sicilisë, Pizës dhe komunistët e Romës. Për secilin prej këtyre grupeve ai bënte nga një karakteristikë të posaçme. Problemi më i madh që konstatonte ministri Pani për të gjitha grupet ishte mungesa e një apo disa figurave që të kishin njohje dhe mbështetje në masën e gjerë të komunistëve. Pani bënte një diferencë mbi mbështetjen që kishte grupi i Sicilisë, i cili sipas tij, kishte shqetësuar edhe udhëheqjen e PKI¹⁰. Për ministrin shqiptar në Romë, problem ishte dhe mosha e anëtarësisë dhe e drejtuesve të grupeve. Kuadrot e grupeve ishin përgjithësisht “të rinj”, pra ishin anëtarë partie që prej viteve 1943-1945, asnjëri prej tyre nuk ishte i brezit të anëtarësisë së viteve ’20-’30. Të gjitha grupet vuajnë nga ndjenja sektare dhe nuk bashkëveprojnë, madje kanë kontradikta me njëri-tjetrin¹¹. Grupi i Milanos dhe disa nga komunistët që kishin kontakte me legatën, si Foschi, Perilli, Molfese e konsiderojnë të nxituar veprimin e grupit të Padovës, i cili doli hapur kundër vijës politike të udhëheqjes të PKI-së. Edhe për ministrin Pani, veprimi i tyre ishte i nxituar pasi “ata duhet të kishin bërë punë përgatitore para se të largoheshin, kështu do të siguronin mbështetje më të madhe. ... Largimi i tyre shtoi frikën te kundërshtarët e Togliattit për të mos punuar aktivisht dhe shumica nuk mbajtën kontakte nga frika se mund të përjashtoheshin”¹². Si anë të pozitive në krijimin e grupit të Padovës ai shihte fillimin e diskutimit rreth mënyrës se si duhet luftuar revizionizmi i PKI-së. Pani shfaqet optimist se “gradualisht një pjesë e

¹⁰ Në një letër që ky grup i dërgonte legatës shqiptare në Romë shprehej shumë i kënaqur për rezultatet që kishin arritur në zgjedhjet parlamentare. “Numri i votave të marra nga kandidati ynë arrin në 16.840 vota dhe janë prova e efektivitetit të mendimin revolucionar, përkundër politikës revizioniste pa shtyllë kurriore, të elementëve që, për fat të keq, kanë përgjegjësinë për të drejtuar PKI”. *Po aty*, F. 14/AP-str., V. 1963, D. 639, fl. 22. Letër e Giuseppe Brancato-s për Jordan Panin, 6 maj 1963.

¹¹ *Po aty*, F. 14/AP-str., V. 1963, D. 636, fl. 19-28. Relacion i ministrit shqiptar në Romë, Jordan Pani për KQ të PPSH, mbi gjendjen në PKI, 19 prill 1962.

¹² *Po aty*, fl. 20.

këtyre komunistëve, ku hapur e ku fshehur, do të merrnin kontakte me shokët e Padovës”¹³.

Sa i takon përgatitjes ideologjike të grupeve, ministri shqiptar vërente se nuk qëndrojnë gjithmonë në pozita të forta, me fjalë të tjera kjo donte të thoshte se nuk e interpretojnë teorinë marksiste, ashtu si drejtuesve shqiptarë do t’u interesonte. Kështu, p.sh. për grupin e Padovës ai konstatonte se “horizonti i tyre nuk është shumë i gjerë, pikëpamjet e tyre në tre numrat e “Viva il Leninismo [Rroftë leninizmi]” përmbajnë një farë papjekurie [siç është] pretendimi me thirrjet e tyre që komunistët të dalin nga partia dhe të organizohen, të krijojnë një udhëheqje të re, një platformë të re. Sot në PKI, siç dihet nuk ka një lëvizje të tillë të brendshme që të pretendosh daljen e komunistave të shëndoshë nga radhët e partisë dhe organizimin e tyre më vetr kundër partisë. Po të dalin sot për sot nga partia gjithë elementët e vendosur mund të formojnë relativisht një grup të ngushtë që do të ketë pak mundësi kontakti me masën e partisë”¹⁴. Për grupin e Perugias, i cili ishte bërë iniciatori i themelimit të shoqatës Itali-Kinë, ndonëse nuk qëndronte vetë në baza trockiste, ishte i prekur nga ide të tilla revizioniste. Grupi i Milanos kishte botuar materiale të PKK-së dhe diskutimet e delegatëve kinezë në kongresin e PKI-së, pra nuk kishte një produkt të vetin. Atë që Jordan Pani e shihte si emergjente për këto grupe ishte të përcaktonin strategjinë nëse do të punonin brenda radhëve të PKI-së, apo do të dilnin jashtë radhëve partiake. *Viva il Leninismo* e Sicilisë ishte dërguar për t’u parë nga udhëheqja e PPSH-së dhe, ka një kritikë të gjatë mbi interpretimet teorike që gjenden aty, por Piro Bità, drejtor i Drejtorisë së Jashtme të KQ të PPSH-së, vë në dukje se ato ishin interpretime të specialistit, por jo linja politike e KQ të PPSH-së.

Ndoshta pa e kuptuar edhe vetë, ministri shqiptar në Romë kishte ngushtuar vëmendjen e drejtuesve të PPSH-së në katër grupe. Gjatë viteve 1963-1964, njëri pas tjetrit përfaqësuesit më të spikatur të tyre morën ftesa për të vizituar Shqipërinë. Qëllimet për bërjen e këtyre vizitave ishin të shumta. Njëri prej qëllimeve ishte vendosja e kontaktit të drejtpërdrejtë mes njerëzve më të spikatur të këtyre grupeve dhe drejtuesve më lartë të PPSH-së, me shpresën që ata do të bëheshin drejtuesit shpirtërorë të marksist-leninistëve italianë. Për më tepër në një

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

ambient më familjar dhe jashtë frikës se po kaloheshin caqet e përgjegjësiive diplomatike, biseda mund të ishte më e thjeshtë. Të dy palët në këto vizita mund të shprehnin hapur çfarë prisnin nga njëra-tjetra. Qëllimi tjetër për ftesa të tilla ishte njohja e realitetit shqiptar nga ana e komunistëve, kuptohet një realitet i kontrolluar dhe i përgatitur me kujdes, në mënyrë që përshtypjet e këtyre vizitave të rrisnin prestigjin e Shqipërisë socialiste në Botë¹⁵. Qëllimi i vizitës kuptohet qartë dhe nga agjenda e saj.

Kështu, më 7-28 korrik erdhën për të pushuar në Shqipëri komunistët italianë Franco Molfese, Mario Paparazzo, Sante Perilli dhe Laura Marconi, ndërsa më 25 gusht-15 shtator 1963 u pritën komunistët e grupit të Pizës, Alberto Bargagna dhe Fosco Dinucci. Të dyja grupet e miqve patën pak a shumë të njëjtën agjendë. Ata vizituan fabrika e uzina, si dhe institucione kulturore në Tiranë, Shkodër, Pogradec, Korçë dhe Durrës. Nëse do të bëhet një krahasim ndërmjet dy grupeve hierarkia e takimeve për grupin e parë ishte më e lartë dhe kjo ishte e pritshme, duke qenë se kontaktet e tyre me përfaqësinë shqiptare ishin më të hershme dhe pikëpamjet e tyre ishin më të qarta. Ata morën pjesë në inaugurimin e disa veprave, si: Hidrocentrali i Shkopetit, Pallatit të Sportit, si dhe në konferencën solemne me rastin e themelimit të Ushtrisë Popullore, ku kishin takuar Enver Hoxhën dhe drejtues të tjerë të PPSH-së. U ftuan për drekë nga Mehmet Shehu, Hysni Kapo dhe Spiro Koleka. Në selinë e KQ të PPSH-së, të dy grupet u pritën zyrtarisht nga sekretari i KQ të PPSH-së, asokohe numri dy i asaj partie, Hysni Kapo, kurse në qytetet që vizituan takuan sekretarët e parë të komiteteve të partisë. Këto takime të nivelit kaq të lartë e kishin bërë Laura Marconin të shprehej: “Si është e mundur dhe ne nuk e kuptojmë dot këtë thjeshtësi kaq të madhe të shokëve udhëheqësa shqiptarë, kaq të dashur, kaq të qeshur. Ka të drejtë populli shqiptar të jetë kaq i lidhur me partinë e tij, të ketë kaq besim dhe në qeverinë e tij. Sa ndryshim kanë këta udhëheqës nga tanët sot. Ja çdo

¹⁵ Me gjithë përgatitjet e shumta për vizitat e miqve të huaj në Shqipëri, vërtetësia e realitetit shqiptar dilte në pah. Në analizat periodike të Komitetit për Marrëdhënie Kulturore dhe Miqësore me Botën e Jashtme (KMKMBJ) ka disa detaje interesante për shërbimet e Albturizmit Shqiptar, të cilat nuk i kushtonin kujdesin e duhur pastërtisë dhe higjienës, qoftë në hotele, qoftë dhe në kuzhinat e restoranteve. Kjo kishte shkaktuar që, në disa raste, miqtë e huaj të largoheshin pa e mbaruar periudhën e caktuar të pushimeve të tyre, pasi mund të ishin helmuar, apo të ishin të pakënaqur nga komoditeti në hotelet e socializmit shqiptar.

të thotë të jesh marksist-leninist i vërtetë. Sa i përgjigjet kjo sjellje shokëve udhëheqësve shqiptarë, parullës që kemi parë të shkruar në mjaft vende: Atë që thotë Partia bën populli, atë që do populli bën partia”¹⁶. Si mund ta dinte komunistja italiane në kaq pak ditë qëndrim, se populli shqiptar i shihte drejtuesit e tij të mbyllur dhe të ruajtur mirë në Bllokun e tyre, vetëm në manifestimet e ndryshme propagandistike. Në përpjekje për t’u bërë përshtypje miqve italianë, Alberta Bargagnas i organizuan një festë me rastin e 69-vjetorit të ditëlindjes.

Më 27 korrik 1963, grupi themelues i Shoqatës Itali-Kinë dha një deklaratë për Agjencinë Telegrafike Shqiptare mbi përshtypjet nga Shqipëria. Deklarata shprehte admirimin e tyre “për vijën e drejtë marksiste-leniniste të partisë sonë, për thjeshtësinë e udhëheqësve tanë dhe të lidhjes së tyre me masat. Ata dënonin qëndrimin e Hrushovit dhe të PKI”¹⁷. Komunistët italianë pohuan se vizita në Shqipëri u dha forca të reja dhe i inkurajoi në luftën kundër revizionizmit modern. “Kur erdha në Shqipëri, - tha Molfese, - kuptohet isha shumë i dëshpëruar që u përjashtova nga partia, por ardhja në Shqipëri më bëri mirë, më dha forca të reja, më dha kurajo dhe guxim, më çeli perspektiva për një punë të palodhur në të ardhmen, sepse shikoj në rrugën e PPSH, rrugën e drejtë marksiste-leniniste, shoh me sytë e mi lidhjen e drejtë të udhëheqjes me masat e popullit në çdo hap, tamam ashtu siç thotë Lenini”. Ndërsa Dinucci shprehej se “Çdo gjë që shoh në vendin tuaj ka vulën e partisë, qoftë industria, bujqësia, arsim-kulturë e të tjera. Po ajo që na bën më tepër përshtypje, është njeriu i ri i edukuar nga partia. Tek ne, si vend kapitalist, njerëzit janë egoistë, mendojnë vetëm për veten e tyre dhe për asgjë tjetër. Kurse tek ju është ndryshe. Njerëzit janë të qartë politikisht, të ngritur nga ana ideologjike dhe të gjithë flasin me pasion dhe gëzim për sektorët e punës së tyre, për perspektivën. Kjo është gjëja kryesore që na ra në sy kudo”¹⁸.

Sa u takon interesave të tyre ideologjike, kërkesat e tyre ishin të ndryshme. Piro Bitia informon ministrin shqiptar në Romë se komunistët italianë të Shoqatës Itali-Kinë kërkuan mendimin e drejtuesve komunistë shqiptarë mbi organizimin e punës së Shoqatës së Miqësisë Itali-Kinë.

¹⁶ AQSH, F. 14/AP-str., V. 1963, D. 638, fl. 17. Relacion i Piro Bitës për drejtuesit e PPSH, pa datë.

¹⁷ *Po aty*, fl. 4. Relacion i Drejtorisë së Jashtme të KQ të PPSH dërguar legatës shqiptare në Romë, mbi vizitën në Shqipëri të shokëve italianë, 28 tetor 1963.

¹⁸ *Po aty*, fl. 17. Relacion i Piro Bitës për drejtuesit e PPSH, pa datë.

Përgjigjia e Bitës ishte se kjo ishte një problem i tyre i brendshëm dhe ata duhet ta gjenin zgjidhjen që ishte më e përshtatshme për ta. Atë që drejtuesit e lartë komunistë e shihnin si domosdoshmëri ishte spastrimi i shoqatës nga elementët trockistë. “Ata e aprovuan këtë mendim, megjithëse Molfese tregohesh deri-diku pesimist përse i përket dëbimit të trockistëve që kanë hyrë në radhët e Shoqatës Itali-Kinë. Ai thoshte “Është i vështirë dëbimi i menjëhershëm i tyre nga rradhët e shoqatës. Për këtë duhet punë dhe kohë”. Kurse Perilli e quante si pesimiste këtë pikëpamje të Molfeses¹⁹. Duket se revolucionarët italianë ishin në kërkim të një mundësie për të siguruar financim për aktivitetin e tyre, pasi ata i kërkuan drejtuesve të PPSH që t’i ngarkonin si përfaqësues të Shqipërisë pranë firmave tregtare në Itali, “me qëllim që me këto të ardhura, të mbulonin një pjesë të shpenzimeve që ata bëjnë duke lëvizur në qytete të ndryshme për të marrë kontakte me shokë të tjerë. Nga ana jonë u muarr angazhimi lidhur me këtë, por nëse ata e ngrënë prapë këtë çështje në bisedime me juve, studiojeni dhe veproni sipas udhëzimeve që ken”²⁰.

Fosco Dinucci interesohej kryesisht për ndihmë ideologjike dhe propagandistike. Ai u takua me drejtorin e Radio-Televizionit, Thanas Nanon, për të biseduar mbi krijimin e mundësisë për dëgjimin më të mirë në Itali, të Radio Tiranës dhe Radio Pekinit. Në takim me kryetarin e Komitetit për Marrëdhënie Kulturore dhe Miqësore me Botën e Jashtme (KMKMBJ), Misto Treska, diskutoi çështjen e organizimit më të mirë të punës së Shoqatës së Miqësisë Itali-Shqipëri²¹. Me drejtorin e Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), Ajet Simitxhiu diskutoi hapjen e një zyre të ATSH-së në Itali, me qëllim që ajo të shpërndante “më tepër materiale ideologjike nga sa shpërndaheshin sot në vendin e tyre”. Me drejtorin e shkollës së Partisë, V.I. Lenin bisedoi rreth programit të shkollës së partisë e të tjera²².

¹⁹ *Po aty*, fl. 7-8. Relacion i Drejtorisë së Jashtme të KQ të PPSH dërguar legatës shqiptare në Romë, mbi vizitën në Shqipëri të shokëve italianë, 28 tetor 1963.

²⁰ *Po aty*.

²¹ “Mbi reflektimin e konfliktit ndërmjet PPSH dhe PKI në funksionimin e Shoqatës së Miqësisë Itali-Shqipëri dhe kalimin e saj në duart e grupeve PKI (m-l)”, *shih*: Nicola Pedrazzi, *Italia che sognava Enver, partigiani, comunisti, marxisti-leninisti, gli amici italiani dell’Albania Popolare (1943-1976)*, Lecce: Salento Books, 2017, f. 437-438.

²² *AQSH*, F. 14/AP str., V. 1963, D. 638, fl. 7-8. Relacion i Drejtorisë së Jashtme të KQ të PPSH dërguar legatës shqiptare në Romë, mbi vizitën në Shqipëri të shokëve italianë, 28 tetor 1963.

Drejtesit e lartë të PPSH-së mbetën shumë të kënaqur nga vizitat, ndonëse përshtypjet për të dyja grupet nuk ishin të njëjta. Për grupin e Perugias ata u shprehën se “megjithëse tregoheshin të gatshëm për të luftuar kundër revizionizmit në udhëheqjen e partisë së tyre nuk kishin në fakt ndonjë gjë konkrete në aktivitetin e tyre, përveç shoqërisë së miqësisë Itali-Kinë. Lidhur me këtë çështje ata patën disa mosmarrëveshje me njëri-tjetrin (Perili dhe e shoqja me dy të tjerët)”. Ndërsa për Dinuccin dhe Bargagnan u shprehën se “të dy shokët e sipërm kanë lënë përshtypje të mirë si shokë seriozë dhe të vendosur në luftën kundër revizionizmit”²³.

Drejtori i Drejtorisë së Jashtme të KQ të PPSH-së, Piro Bita, porosiste Jordan Panin të vazhdonte kontaktet me secilin prej këtyre komunistëve “duke pasur parasysh që ju të mos bini në sy dhe këta të mos kompromentohen para udhëheqjes të partisë revizioniste të PKI. ... Komunistët italianë që vizituan këtë vit vendin tonë e ndjejnë se kanë përfituar shumë me skjarimin e shumë çështjeve, por me kalimin e kohës, ata do ta ndjejnë përsëri nevojën e kontakteve me ne. Prandaj me ta, të punohet me takt, të ndihmohen në zgjidhjet e problemeve që kanë, por gjithmonë me takt dhe duke çfaqur mendime personale dhe duke u thënë ato jo në formë udhëzimesh, por gjatë bisedave shoqërore pasi të jenë dëgjuar nga ju mendimet e tyre deri në fund dhe duke aprovuar mendimet e tyre më pozitive, natyrisht duke i thelluar ata më tepër, por që të lihet përshtypja se ata qenë mendime të tyre dhe tuajat”²⁴.

Gjatë vitit 1964, përpjekjet për të krijuar një parti komuniste marksiste-leniniste në Itali u shtuan dhe puna e përfaqësisë në këtë drejtim u intensifikua aq shumë sa shkaktoi shqetësim për ndonjë komprometim të mundshëm të diplomatëve shqiptarë. Në të vërtetë, qetësinë e Tiranës e prishi një incident i ndodhur në përfaqësinë në Romë. Një prej radistëve të legatës kërkoi strehim politik në Itali dhe fakti që ai ishte në dijeni të të gjitha lëvizjeve të diplomatëve shqiptarë në Romë në lidhje me lëvizjen komuniste, mund të ketë shtuar frikën për një dekonspirim të mundshëm. Gjatë pranverës së vitit 1964, Piro Bita vizitoi selitë e përfaqësive shqiptare në Itali, Austri e Francë. Ai shfrytëzoi rastin për të takuar edhe komunistët marksistë-leninistë në këto vende. Në Itali

²³ *Po aty*, fl. 18. Relacion i Drejtorisë së Jashtme të KQ të PPSH dërguar legatës shqiptare në Romë, mbi vizitën në Shqipëri të shokëve italianë, 28 tetor 1963.

²⁴ *Po aty*.

bisedoi me Dinuccin, Molfesen dhe Papparazzon. Por qëllimi kryesor i vizitës ishte të asistonte në analizën vjetore të ambasadës dhe të jepte udhëzimet mbi vijimin e punës me komunistët marksistë-leninistë.

Vërejtja kryesore në raportin e Piro Bitës ishte se puna e përfaqësisë ishte kufizuar vetëm në punën me grupet komuniste. Por edhe për drejtuesit raporti shfaqte disa vërejtje. Një nga vërejtjet për Jordan Panin ishte se nuk zbatonte porosinë e drejtuesve të PPSH-së dhe nuk tregonte kujdes me komunistët italianë. Një nga shembujt që u morën në mbledhjen e përfaqësisë me Piro Bitën, ishte debati i ashpër i J. Panit me Giuseppe Regisin e Grupit të Milanos, mbi numrin e gazetës që do të botonin. E vërteta është se diskutimi mbi revistën kishte zgjatur rreth 5-6 orë dhe të dy bashkëbiseduesit kishin ngritur mjaft tonet e bisedës. Por, atë që nuk e tha në mbledhje Jordan Pani, ishte se para diskutimit me Regis-in për revistën, ai kishte marrë një letër të detajuar, ku i kërkohej të diskutonte me Regisin mbi këtë çështje dhe vërejtjet të dilnin si personale, pasi “mbi këto parime nuk bëhet lëshim”²⁵. Fakti që probleme të ngjashme haseshin edhe në përfaqësitë e Vjenës dhe të Parisit, tregon që këmbëngulja e drejtuesve të PPSH-së për të ndikuar mbi grupet marksiste-leniniste nuk u linte shumë hapësira përfaqësuesve diplomatikë për të mbajtur pozicionin që u takonte në bazë të funksionit diplomatik që kryenin.

E dyta, vërejtja e raportit të Piro Bitës lidhet me moskujdesin në ruajtjen e “përfaqësive tona dhe i interesave të vendit tonë nga çdo provokator, si dhe nga qeveritë e atyre vendeve”²⁶. Roma ishte sërish ajo që kishte gabuar më shumë. Sipas Bitës, Jordan Pani kishte vizituar Napolin, Milanon ose Firenzen dhe ka shkuar drejt e në shtëpi ose në vendet ku punojnë grupet komuniste, ka biseduar për orë të tëra me ta dhe pas mbledhjes është kthyer menjëherë në Romë. Ai nuk i kishte kombinuar këto vizita me ndonjë punë tjetër, që do të kishte shërbyer si pretekst për këto udhëtime. Drejtori i drejtorisë politike të KQ të PPSH shqetësohej se këto vizita mund të binin në sy “të organeve italiane, të cilët në raste të caktuara mund t’i shfrytëzojnë kundër nesh”²⁷.

²⁵ *Po aty*, F. 14/AP-str., V. 1964, D. 645, fl. 3. Letër e Hysni Kapos për Jordan Panin, shkurt 1964.

²⁶ *Po aty*, F. 14/AP-str., V. 1964, D. 819, fl. 3. Relacion i Piro Bitës mbi vizitën në përfaqësitë shqiptare në Itali, Austri e Francë.

²⁷ *Po aty*.

P. Bita u ofroi eprorëve të vet shembullin si punojnë diplomatët kinezë me grupet marksiste-leniniste. Titullarët e përfaqësive kineze nuk merrnin asnjëherë kontakt me grupet marksiste-leniniste, madje ata bënëin të paditurin dhe në biseda private me shqiptarët. Këto kontakte në përfaqësitë kineze i mbanin zakonisht punonjës të nivelit të ulët të përfaqësisë. Për më tepër, diplomatët kinezë nuk bënëin punë me të gjithë grupet që ishin krijuar në një shtet, ato fokusohen te grupi më i fuqishëm. Por, komunistët shqiptarë nuk e kishin këtë luks. Grupet marksiste-leniniste i kërkonin dhe përpiqeshin me të gjitha forcat për të vendosur kontakte me diplomatët kinezë, ndërsa në rastin e Shqipërisë, situata ishte ndryshe. Ishin diplomatët shqiptarë që ndiqnin me kujdes grupet në përpjekje për t'i përdorur si bazë mbështetjeje. Këtë gjë mesa duket kishte parasysh dhe Piro Bita kur shprehet se përvoja shqiptare ishte më e drejtë “pasi kështu evitoheshin gabimet që mund të vinin nga mungesa e informacionit”²⁸.

Pavarësisht udhëzimeve për të ruajtur imazhin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të grupeve marksiste-leniniste, fakt është se drejtuesit e PPSH-së ndikuan fuqishëm, madje dhe kontrolluan veprimtarinë e tyre. Këtij qëllimi i shërbente dhe puna e përfaqësisë shqiptare në Romë, e cila në çdo rast ndiqte udhëzimet e qendrës, që deri në mesin e vitit 1964, të paktën sipas relacioneve të Piro Bitës, nuk ishin të koordinuara me PKK-së. Madje, Piro Bita propozon që Nesti Nase të bënte ndonjë bisedë në Pekin mbi gjendjen e lëvizjes revolucionare në këto vende²⁹.

Ndonëse në dokumente nuk del qartë, një nga çështjet për të cilët kishin nevojë për konsultime drejtuesit e PPSH-së ishte se cilin nga grupet komuniste duhet të mbështesnin për t'u bërë qendër e gravitacionit për grupet e tjera dhe cilin nga komunistët marksistë-leninistë duhet të promovonin si drejtues të grupit. Deri në korrik të vitit 1964 ende nuk ishte vendosur asgjë, pasi me ftesë të KQ të PPSH-së ende vazhdonin të ftoheshin komunistë italianë nga të katër grupet dhe nga biseda që zhvillohej me ta dhe nga konkluzionet e takimeve çështja e liderit ende nuk ishte e qartë. Kështu, nga 21 komunistët italianë të planifikuar për t'u ftuar në vitin 1964, me fondet e KQ të PPSH-së, do të ishin Mario Turzioni i grupit të Firences, Giuseppe Regis i grupit të Milanos, Arturo

²⁸ *Po aty*, fl. 7.

²⁹ *Po aty*.

Balesti i grupit të Pizës, Ugo Duse i grupit të Padovas, Aldo Pugliese si arbëresh dhe Giovanni Pesce si mik i Mehmet Shehut³⁰.

Gjithsesi, duhet thënë se emri i Fosco Dinuccit kishte filluar të veçohej në kokën e udhëheqjes shqiptare. Piro Bitë shprehet se ai ishte më i miri që KQ i PPSH-së kishte ftuar. Edhe ai përfaqësonte “kuadrot e rinj”, por mbështetej nga njerëz me shumë reputacion në zonën e tij, njëri prej të cilëve ishte Alberto Bargagna. Ai konsiderohet revolucionar, ishte shumë familjar me teorinë marksiste duke qenë se kishte qenë lektor në shkollën e partisë së Torinos dhe Romës. “Dua të shfaq mendimin tim me këtë rast, shkruante Jordan Pani, se Dinucci është nga kuadrot më me perspektivë për punën revolucionare këtu në Itali (e kam fjalën nga ata që kam njohur unë deri tani) është më në gjendje dhe nga ata të Padovës apo të Milanos etj. Prandaj e vlen që të bisedojë më të, mendoj, edhe ndonjë shok kryesor dhe t’i jepet mundësia të takohet me shokët kinezë për punën e revistës dhe të ndihmohet sa të jetë e mundur”³¹. Ndonëse nuk pranonin që kishte ndarje midis PPSH-së dhe PKK-së kishte preferenca në mbështetjen e grupeve³², mendoj që për drejtuesit e PPSH-së kishte rëndësi të mbështesnin dikë që dukej më afër me ta. Sa i takon Dinuccit mendimi i përgjithshëm ishte se ai mbante më shumë kontakte me shqiptarët, ndryshe nga grupi i Milanos, i cili ishte më i lidhur me kinezët. Për ironi të fatit, dyshoj se ishin pikërisht kinezët që i dhanë mundësinë Dinuccit të vihej në krye të Lëvizjes Marksiste-Leniniste Italiane, pavarësisht se kjo çështje nuk mund të thuhet me siguri pa parë dhe dokumentet kineze. Pas takimit të Piro Bitës me ambasadorin kinez në Romë, ai i raporton qendrës se “nga sa shtruan shokët kinezë për grupet në Itali (ishte e qartë se ata e kishin për grupin e Pizës, sado që nuk e cilësuan asnjëherë me emër) janë shumë seriozë dhe mendoj se nuk duhet të prisnin rastin që vajta unë për të na i thënë”³³.

Në vjeshtë të vitit 1964, drejtuesit komunistë shqiptarë shpreheshin të kënaqur për shkallën e zhvillimit të lëvizjes kryesiste marksiste-leniniste në Itali. Në fjalën e tij në seminarin me titullarët e përfaqësive

³⁰ *Po aty*, F. 14/AP-str, V. 1964, D. 630, fl. 5. Lista e komunistëve italianë të planifikuar për t’u ftuar në Shqipëri gjatë vitit 1964.

³¹ *Po aty*, fl. 4. Shënime biografike të përgatitura nga legata shqiptare në Romë për komunistët italianë që do të ftohen në Shqipëri, 19 mars 1964.

³² N. Pedrazzi, *Italia che sognava Enver ...*, f. 380.

³³ *AQSH*, F. 14/AP-str, V. 1964, D. 819, fl. 7. Relacion i Piro Bitës mbi vizitën në përfaqësitë shqiptare në Itali, Austri, Francë.

shqiptare në Botë, Hysni Kapo, duke marrë edhe meritat për organizimin e lëvizjes marksiste-leniniste në të gjithë botën, sa u takon zhvillimeve në Itali e quante sukses që atje katër grupet kryesore marksiste-leniniste ishin bashkuar dhe kishin krijuar një komiteti politik, i cili po botonte edhe një gazetë të përmuajshme "Nuova Unita". Sipas Kapos, ky ishte një hap përpara i marksistëve-leninistëve italianë, të cilën PPSH e kishte përkratur publikisht. Kapo vinte, gjithashtu, në dukje se bashkimi i grupeve nuk ishte shumë solid për shkak të divergjencave që ekzistonin midis grupeve dhe brenda çdo grupi. Ai e konsideronte pozitive mbledhjen kombëtare të gjithë grupeve marksiste-leniniste që u mbajt në korrik në Milano dhe vendimin e saj për të formuar një "parti e tipit të ri, si e vetmja rrugë dalje për të luftuar me sukses kundër borgjezisë revizioniste të PKI dhe për të organizuar masat në luftën e pushtetit"³⁴.

Gazeta "Nuova Unita" është akoma e dobët nga përmbajtja, sidomos përse i përket diskutimit të problemeve të brendshme të Italisë. "Është pozitiv fakti se këtë të metë e kuptonin plotësisht shokët e komitetit politik dhe se perspektiva është që jo vetëm të përmirësohet përmbajtja e saj, por edhe të botohet së shpejti 2 herë në muaj. Ajo botohet 25000 kopje. Sot për sot të gjithë këta grupe së bashku numërojnë vetëm disa qindra anëtarë ose simpatizantë dhe nuk janë hedhur akoma në aktivitete masive revolucionare, me ndonjë përjashtim të rrallë, por perspektivat e punës së tyre, nga sa duket, janë të mira"³⁵.

Drejtuesit e lartë të PPSH-së kishin të drejtë të ishin të kënaqur për krijimin e Komitetit dhe organizimin e grupeve marksiste-leniniste të Italisë. Ata kishin arritur atë që dëshironin, një organizatë që të ndante të njëjtat linja ideologjike me PPSH-në dhe që do të shërbente për propagandimin e "sukseseve të socializmit shqiptar". Kjo, në të vërtetë ishte një detyrë, të cilën marksistë-leninistët italianë dhe të gjithë të tjerët e kryen me shumë devotshmëri.

"Misioni i dështuar" për të fituar Pietro Secchian

Ashtu si është përmendur dhe në fillim të këtij shkrimi, drejtuesit e lartë të PPSH-së kishin dhënë udhëzime të qarta për legatën shqiptare në Romë për të vendosur kontakte dhe për të tërhequr miqtë e Shqipërisë.

³⁴ *Po aty*, F. 14/AP-str, V. 1964, D. 590, fl. 220-221. Të dhëna mbi gjendjen e forcave marksiste-leniniste që luftojnë revizionizmin, e mbajtur nga Hysni Kapo, shtator 1964.

³⁵ *Po aty*.

Vëmendja u përqendrua tek ata komunistë që kishin pozicione drejtuese brenda radhëve të PKI-së, si: Terracini, Secchia, D'Onofrio, Scoccimaro³⁶ etj. Këta kishin treguar një lloj opozicioni ndaj tezave të Togliattit, të cilat, në thelb, kërkonin braktisjen tërësisht të rrugës revolucionare për ndërtimin e një shteti socialist. Duke u nisur nga ky pozicion i tyre, por edhe nga fakti se, më herët, kishin dëshmuar ndjenja miqësore ndaj Shqipërisë dhe udhëheqësve të saj, drejtuesit e PPSH shprehonin se ata mund të shërbenin si pika gravitacioni që mund të bashkonin ata komunistë italianë që kundërshtonin politikën e drejtuesve të PKI-së. Ashtu si e tregoi zhvillimi i ngjarjeve, shumë prej këtyre personaliteteve nuk e përkrahën PPSH-në në konfliktin e saj ideologjik me BS-në dhe drejtuesit e PKI-së. Në këto rrethana, edhe pse disa prej tyre vijonin të shprehnin ndjenja miqësore për popullin shqiptar, porosia e Tiranës ishte të mos kontaktoheshin më.

Pietro Secchia ishte një prej personaliteteve brenda PKI-së, me të cilin u komunikua më shumë dhe më gjatë. Njëra nga arsytet që ai u dallua nga të tjerët ishte dhe për shkak të një bisede që kishte zhvilluar me drejtuesit e lartë të PPSH-së, gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri në vitin 1960. Sipas një letre që Hysni Kapo i dërgon Manush Myftiut, Secchia “kur ishte në vitin 1960 në Shqipëri na foli hapur kundër Hrushovit, kundër Togliattit dhe u çfaq dakord me qëndrimin e partisë tonë dhe me shokët kinezë. Bile Secchia na tha se unë jam gati të dal hapët kundra Togliattit, Hrushovit etj., por këtë gjë nuk mund ta bëj vetë, duke gjykuar interesat e ngushta brenda për brenda në Partinë Komuniste Italiane, këtë duhet ta bëj nëse e kërkon interesi i përgjithshëm dhe për ta bërë këtë unë dua të kem edhe pëlqimin tuaj dhe të Partisë Komuniste Kineze, pse ju e dini më përpara kish një qendër ku komunistat revolucionarë

³⁶ Mauro Scoccimarro-s, nënpresidentit komunist të Senatit italian, KQ i PPSH-së i dërgoi një dhuratë, mesa duket për të kuptuar qëndrimin e tij karshi udhëheqjes komuniste shqiptare. Në një letër që ai i shkruan KQ të PPSH-së, më 27 maj 1962, pasi shpreh falënderimet për dhuratën, shpreh kundërshtimet për qëndrimin e mbajtur nga PPSH-ja. Për tekstin e letrës së Scoccimarro-s, *shih*: N. Pedrazzi, *Albania che sognava Enver ...*, f. 332. Në tekstin e përgjigjes, të përkthyer në shqip, Enver Hoxha, pasi përdor një fjalë fyese për mikun e dikurshëm italian, vendos shënimin që letra të shkojë në arkiv, ndërsa Hysni Kapo urdhëron të njoftohet ministri italian në Romë, Jordan Pani. Scoccimarro nuk ishte më në listën e miqve të Shqipërisë. *AQSH*. F. 14/AP-MPKI, V. 1962, D. 2, fl. 2. Shënime me shkrim dore të Enver Hoxhës dhe Hysni Kapos.

mbështeteshin dhe këshilloheshin si të vepronin, Kominterni, tashti nuk ka”³⁷.

Më 2 mars 1962, në orët e vona të mbrëmjes, Jordan Pani dhe Sotir Vangjeli zhvilluan një takim me Pietro Secchian në shtëpinë e këtij të fundit. Takimi zhvillohej me porosi të drejtuesve të KQ të PPSH-së³⁸. Gjatë takimit Secchia kishte shprehur keqardhjen e tij që nuk kishte mundur të takonte Abdyl Këllezin, i cili kishte vizituar Romën disa ditë përpara, pasi, siç shprehet ai, përveçse dëshironte të kujtonte kohët e vjetra me të, donte të fliste dhe për situatën e krijuar në lëvizjen ndërkombëtare. Secchia ishte interesuar për çka po ndodhte me Shqipërinë pas prishjes së marrëdhënieve me BS-në, ai u interesua për akuzat që i bëheshin PPSH-së, ashpërsinë në dënimin e kundërshtarëve brenda radhëve të saj, veçanërisht për dënimin e Liri Gegës dhe Teme Sejkos. Secchia pohoi se gjykonte të gabuar, revizioniste dhe antimarksiste, madje dhe “të djathtë” vijën politike të PKI-së, por ai ndihej konfuz për hapat e mëtejshëm që duhet të ndërmerreshin. Ai mendonte se partitë që kishin kundërshtuar Hrushovin, duhet të koordinonin veprimet. “Midis elementeve të njërës ose tjetrës parti që kanë pikëpamje të njëjlojta, - thoshte ai, - duhet të ketë një marrëveshje në shkallë ndërkombëtare për të dalë hapur në këtë çështje në partitë respektive. ... Ja të marrim rastin tim, - tha,- shkak duan që të më likuidojnë megjithëse edhe kështu po më likuidojnë. Duhet me ditë nëse ka ardhur koha për të dalë hapur në partinë tonë apo në partitë e tjera dhe nëse po, me e bë këtë marrëveshje, sepse dhe kinezët po mundohen mos dalin hapur, me shpresë për të ruajtur unitetin e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste, me shpresë se mos kapërcehen kontradiktat. Ky qëndrim të bën të mendosh se mos bëj gabim. S’ka ndonjë udhëzim nga kinezët si të veprohet, as nga ju s’ka ndonjë udhëzim që ne të dalim hapur se po të kishit ndonjë udhëzim do ta thoshit. Unë shpresoja, - tha, - se ndonjë gjë do ta thoshte shoku Abdyl”³⁹.

Rezultatet e takimit të ministrit shqiptar në Romë me Pietro Secchian e entuziazmuan Enver Hoxhën. Në ditarin e tij, ai shkruante se ishte i

³⁷ *Po aty*, F. 14/AP-str., V. 1964, D. 633, fl. 1. Letër e Hysni Kapos për Manush Myftiun mbi takimin me Secchia-n, 25 janar 1964.

³⁸ *Po aty*, F. 14/AP-str., V. 1962, D. 561, fl. 1. Informacion mbi takimin e zhvilluar mes Jordan Panit dhe Pietro Secchia-s, 2 mars 1962.

³⁹ *Po aty*, fl. 3-4. Informacion mbi takimin e zhvilluar mes Jordan Panit dhe Pietro Secchia-s, 2 mars 1962.

kënaqur për këtë takim⁴⁰. Me urgjencë ai thirri ministrin shqiptar në Romë, Jordan Pani në Tiranë, për të zhvilluar një takim kokë më kokë me të. Për fat të keq, dokumentimi i bashkëbisedimit të tyre nuk është gjetur, por nga ajo çfarë shkruan Hoxha në ditarin e tij dhe zhvillimet e mëvonshme të ngjarjeve tregon se është diskutuar pikërisht për punën e mëtejshme që duhet të bënin diplomatët shqiptarë me miqtë e Shqipërisë dhe mbështetësit e tezave shqiptaro-kineze.

Kështu, kur ministri shqiptar në Romë takoi sërish Secchian më 25 maj 1962, ai kishte tashmë udhëzimet që i mungonin gjatë bisedës së parë. Këtë herë takimi u zhvillua në shtëpinë e Sotir Vangjelit dhe Secchias iu përcollën përsëritetjet e ngrohta e miqësore të Enver Hoxhës. Jordan Pani e njoftoi gjithashtu se ishte porosia e udhëheqësit komunist shqiptar që Secchia të njihej me të gjitha materialet e brendshme që tregonin pikëpamjet e PPSH-së dhe arsyet e konfliktit midis PPSH-së dhe PKBS-së, duke përfshirë dhe korrespondencën midis shqiptarëve dhe kinezëve, apo kinezëve dhe sovjetikëve.

Duket që dokumentet e ofruara nuk shërbyen shumë për ta bindur Secchian. Fakti që PKK-ja nuk vendoste të dilte hapur dhe t'i dëshmonte botës komuniste thelbin e divergjencave ideologjike, për komunistin italian ishte një mangësi shumë e madhe dhe nuk e ndihmonte aspak situatën. “Tani fatkeqësisht, - ishte shprehur Secchia, - ka filluar diplomacia dhe në marrëdhëniet midis partive. E kam fjalën, për letrat e sovjetikëve dhe të kinezëve se përsa i përket tuajës ajo i shtron çështjet hapur. ... Kinezët duke kritikuar revizionizmin jugosllav e kanë fjalën për Hrushovin dhe sovjetikët. Por pse kjo të ndodhë me mbulesa. Kjo nuk e ngre autoritetin e partive dhe të lëvizjes”⁴¹. Ai dukej i pakënaqur dhe me mbrojtjen që kinezët u kishin bërë shqiptarëve karshi sjelljes së sovjetikëve. Sipas Seccias, kinezët dënonin metodat sovjetike karshi PPSH-së dhe Shqipërisë, por mbi divergjencat ideologjike qëndrimi ishte shumë i kamufluar, në një kohë kur “dihet fakti se ju për të mbrojtur këto pikëpamje që janë të kinezëve dhe tuajat, pësuar këto sulme dhe gjithë metodat që përmenden”⁴².

⁴⁰ Enver Hoxha, *Ditar për çështje ndërkombëtare (1961-1963)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 313-314. “Deklarata e Pietro Sekias”, e diel 1 prill 1962.

⁴¹ *AQSH*, F. 14/AP-str., V. 1962, D. 561, fl. 10. Informacion mbi takimin e zhvilluar mes Jordan Panit dhe Pietro Secchia-s, 25 maj 1962.

⁴² *Po aty*, fl. 11.

Secchia kishte vërejtje dhe për qëndrimin e Shqipërisë në këtë konflikt ideologjik. Komunistët shqiptarë duket të kishin përdorur më pak retorikë dhe më shumë argumente në komunikimet e tyre me sovjetikët. Ndonëse ishte dakord për një pjesë të madhe të çështjeve që mbronin shqiptarët ai, gjithashtu, vërente se kishte pasaktësi në akuzat që ngriheshin. Njëra prej tyre ishte p.sh. akuza sipas së cilës BS-ja nuk i kishte ndihmuar partitë komuniste në vendet kapitaliste, për të cilën Secchia mendonte se ishte e pasaktë. Pakënaqësi shprehu Secchia dhe për ashpërsinë e komunikimit të drejtuesve të PPSH-së⁴³. “Për mbledhjen e

⁴³ Qëndrimi intransigjent i PPSH-së u shpreh dhe në marrëdhënie me PKI-në, e cila në mënyrë të përsëritur kishte shprehur qëndrimin e saj për të gjetur një rrugë për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Gjatë vitit 1961-1962, marrëdhëniet ndërmjet dy partive kishin ruajtur një lloj kordialiteti diplomatik dhe disa mesazhe urimi ishin shkëmbyer mes tyre. Drejtuesve të lartë të PPSH-së u kishin mbërritur sinjale për dëshirën e PKI-së për të mos e mbajtur të acaruar situatën në marrëdhëniet mes partive komuniste. P. Secchia kishte pohuar gjatë takimit me Jordan Panin se ishte duke punuar për botimin e veprave të Maos, për të cilin nuk kishte urdhër nga Partia e tij për të mos e vazhduar punën. Sinjale të qarta për qëndrimin e zbutur të PKI-së kishte dhënë edhe sekretari i Shoqatës së Miqësisë Itali-Shqipëri, Franco Portone. Ky gjatë një takimi që kishin zhvilluar në ambasadën shqiptare në Romë në lidhje me vazhdimin e punës së Shoqatës së Miqësisë ishte shprehur se: “Orientimi nga Partia është që shoqata do të punojë si dhe më parë. Këtë unë ia u kam thënë edhe më parë për të cilën kam qenë dërguar apostafat nga Partia. Partia e jonë është për marrëdhënie të mira me të gjitha partitë në këtë numër [midis tyre] edhe me Partinë e Shqipërisë. Në qoftë se e keni vënë re, kohët e fundit Unita-ja nuk ka shkruar keq për Shqipërinë, përkundrazi botoi fjalimin e Çu En Lait në banketin që u dha në Pekin për nder të delegacionit ekonomik shqiptar, ka botuar lajmet mbi marrëdhëniet tregtare që ka përfunduar Shqipëria me vendet e tjera socialiste dhe jo socialiste dhe sot boton artikullin e gazetës “Zëri i Popullit” për çështjen e çarmatimit. Përveç kësaj ju duhet të vlerësoni dhe disa simptoma të tjera të cilat lënë të kuptohet që partija e jonë është për marrëdhënie të mira p.sh në Festën e 29 Nëntorit në pritje erdhën Terracini dhe D’Onofrio dhe në konferencën që organizoi shoqata për hapjen e vitit kultural erdhni përsëri Terracini. Shqipëria konsiderohet nga partia, vend socialist dhe se pjesa dërrmuese e KQ nuk aprovon prerjen e marrëdhënieve diplomatike që bëri BS me Shqipërinë, si dhe pikëpamjet e tij politike dhe ideologjike të papranueshme”. (AQSH, F. 14/AP-str., V. 1961, D. 563, fl. 1. Relacion i Jordan Panit, për KQ të PPSH, 31 mars 1962.). Këtyre sinjaleve pozitive që vinin nga PKI-ja, komunistët shqiptarë iu përgjigjën me dogmatizmin e zakonshëm. Jordan Pani qëndrimin e PKI-së e gjykoi si pjesë e oportunitizmit tipik të saj, e cila dëshironte të mbante një derë hapur nëse marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik normalizoheshin. Diplomatët shqiptarë nuk e zbutën retorikën kundër PKI-së dhe drejtuesve të saj politikë, gjë që u dëshmuua dhe nga udhëtimi i tyre në Kalabri. Ai me shumë mundësi zhvillohej në kuadër të aktiviteteve të Shoqatës së Miqësisë Itali-Shqipëri, sepse ministrin e sapoemëruar

81 partive në Moskë disa shokë që ishin aty më treguan se midis kinezëve dhe sovjetikëve mosmarrëveshjet u paraqitën të thella për shumë çështje, por kinezët në një formë të argumentuar e të trajtuar në mënyre të thelluar i shtruan çështjet dhe në frymë shoqërore, ndërsa shqiptarët i shtruan çështjet në një formë të atillë që është vështirë të diskutohesh më tej. Unë, - tha ai,- nuk i besova këto gjëra duke u nisur nga gjithë shpifjet që bëheshin për ju, por në këtë letër shoh se ka disa gjëra që shtrohen shumë direkte dhe rëndë”⁴⁴.

Pavarësisht pakënaqësive dhe dyshimeve që shprehu Secchia dhe shpjegimet mjaft dogmatike që iu ofruan atij nga diplomatët shqiptarë, takimi ishte miqësor. Në fund të tij, ministri shqiptar i ofroi dhe mesazhin më të rëndësishëm, i cili ishte në të vërtetë dhe qëllimi i takimit, mesazhin e Enver Hoxhës për ndihmë dhe mbështetje për komunistët italianë që ishin të gatshëm t’i bashkoheshin luftës së PPSH dhe PKK për të kundërshtuar “revizionizmin modern”. “Para se të ndaheshim me të unë i thashë se shoku Enver më porositi t’i them se në çdo rast dhe për çdo gjë ne do të jemi gati brenda çdo mundësie t’u ndihmojmë, ndërsa Shqipërinë ta shihni si atdhe socialist për çdo rast”⁴⁵.

Gjatë vitit 1962, ministri shqiptar në Romë zhvilloi dhe tri takime të tjera me Pietro Secchian. Një insistim i tillë, natyrshëm të bën të analizosh mbi arsyet e drejtuesve të PPSH-së për të. Pietro Secchia kishte

shqiptar në Romë, Jordan Panin, dhe sekretarin e ambasadës Sazan Guri në këtë udhëtim i shoqëronte Franco Portone, sekretar i Shoqatës së Miqësisë. Zyrtarisht diplomatët shqiptarë i ishin përgjigjur ftesës së kryetarit të komunës, Aldo Puglise-s, i cili ishte komunist, për të marrë pjesë në festivalin e këngëve dhe valleve arbëreshe që zhvillohej në atë zonë. (AQSH, F. 14/AP-str., V. 1961, D. 563, fl. 5. Relacion i Jordan Panit për KQ të PPSH lidhur me udhëtimin në Kalabri, 5 maj 1962). Sipas informacioneve që diplomatët komunistë i dërguan qendrës, në këtë udhëtim ata kishin takuar vëllezërit Puglise (Aldo dhe Giuseppe), i pari kryetar i komunës dhe të dy komunistë, të cilët ishin interesuar për konfliktin shqiptaro-sovjetik. Diplomatët shqiptarë kishin folur gjerë e gjatë për konfliktin, duke atakuar edhe PKI dhe drejtuesit e saj, veçanërisht Togliatti-n, aq sa Franco Portone, kundër natyrës së vet, ishte detyruar të kundërshtonte, madje ashpër (*Po aty*, F. 14/AP-MPKI, V. 1962, D. 1, fl. 3. Letër e Jordan Panit, ambasador shqiptar në Romë, për Hysni Kapon lidhur me udhëtimin në Kalabri, 13 qershor 1962). Giancarlo Pajeta në emër të PKI protestoi për qëndrimin e diplomatëve shqiptarë gjatë këtij udhëtimi. Për më tepër mbi letërkëmbimin midis Pajetës dhe Bitës shih: N. Petrazzi, *Italia che sognava Enver ...*, f. 331.

⁴⁴ AQSH, F. 14/AP-str., V. 1962, D. 561, fl. 14. Informacion mbi takimin e zhvilluar mes Jordan Panit dhe Pietro Secchia-s, 25 maj 1962.

⁴⁵ *Po aty*.

qenë një nga drejtuesit kryesorë të PKI-së, sekretar i KQ të PKI-së, kryetar i grupit parlamentar të PKI-së, revolucionar i vjetër, pjesëmarrës aktiv i rezistencës italiane, njeri me shumë reputacion dhe mbështetje nga komunistët italianë. Ai kishte kundërshtuar hapur në disa raste tezat e hedhura nga Togliatti në Kongresin VIII të PKI-së dhe kishte dëshmuar se mbështeste PKK-në dhe PPSH-në në tezat që kishin shfaqur në Mbledhjen e 81 Partive. Lidhjet e Secchias me një pjesë të drejtuesve shqiptarë ishin të hershme dhe datonin që prej Luftës së Dytë Botërore, kur ai ishte njohur me Abdyl Këllezin, Sadik Bekteshin, Qemal Kapizysin etj., gjatë kohës që kishin kaluar së bashku në kampin e internimit fashist të Ventotenes. Secchia kishte vizituar dy herë, Shqipërinë gjatë viteve 1957 dhe 1959, ku ishte lejuar të zhvillonte dhe vizita private në shtëpitë e miqve të tij të luftës⁴⁶, gjë jo fort e zakonshme në praktikën e asaj kohe dhe që tregonte për besimin e madh që kishin drejtuesit e lartë të PPSH-së te personaliteti i tij. Deri në këtë kohë, nuk ka të dhëna që drejtuesit komunistë shqiptarë, të dinin pozitën e brishtë të Secchias në drejtimin e PKI-së, për shkak të incidentit me asistentin e tij. Këto informacione dokumentohen t'i jenë ofruar drejtuesve të lartë të PPSH-së dy vite më vonë, gjatë vizitës së Quinto Antoniettit në Shqipëri, por gjithsesi nuk duket që ky informacion të ketë shkaktuar ndonjë shqetësim te drejtuesit më të lartë komunistë shqiptarë.

Secchia ishte kandidati më i mundshëm për të drejtuar një parti revolucionare në Itali dhe drejtuesit komunistë shqiptarë mendonin që kishte një potencial të jashtëzakonshëm për një lëvizje revolucionare, e mbështetur mbi dogmat origjinale të marksizëm-leninizmit, e cila do të ndihmonte zhvillimin dhe fitoren e revolucionit socialist në Itali. Por, Secchia nuk ishte vetëm revolucionar i vjetër, ai ishte dhe politikan karriere dhe, në një moshë të shtyrë, nuk mund të bëhej pjesë e aventurave ku kërkonte ta përfshinte Hoxha. Në një takim të zhvilluar në tetor 1962, Secchia u foli hapur diplomatëve shqiptarë se situata nuk po zhvillohej në favor të tyre. Ai e shihte se në masën më të madhe të komunistëve italianë ka paqartësi për çfarë po ndodh në lëvizjen komuniste. “Masa kujton se punët me kinezët shkojnë mirë se janë disa

⁴⁶ Vera Bekteshi, *Vila me dy porta*, Tiranë: Fjala, 2014, f. 42.

gjëra që diskutohen, por pa rëndësi. Kinezët duhet të dalin hapur me një kritikë që i adresohet jo vetëm jugosllavëve, por edhe sovjetikëve”⁴⁷.

Me fjalë të tjera, Secchia kërkonte garanci se Kina e Mao Ce Dunit ishte në krye të rebelimit ndaj Moskës. Logjikshëm, Secchia besonte te Kina e Madhe dhe jo te Shqipëria e Vogël. Përgjigjja e Secchias ishte një dush me ujë të ftohtë për megalomaninë e Enver Hoxhës. Në ditarin e tij ai do të përdorte një gjuhë fyese kundër tij “Sekia pipino është dhe prapëseprapë pipino mbetet, i frikësuar dhe pesimist, derisa arrin të thotë: “S’kemi ç’bëjmë, revizionistët në Itali kanë fuqinë në Parti” etj. Por edhe ne ç’të bëjmë, do ta mbajmë afër, do ta inkurajojmë se është më i miri nga të tjerët. Thuhet se Kolomboja është më kurajozi në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Italiane”⁴⁸.

Gjatë vitit 1963-1964, kur u konstatua se asnjë prej grupeve marksiste-leniniste nuk kishte figura të spikatura lideri dhe kur çështja e bashkimit të grupeve marksiste-leniniste po diskutohet gjerësisht, nevoja e një drejtuesi, që duhet të kishte reputacionin dhe peshën e duhur politike e që të pranohej nga të gjithë të tjerët si lider, u konsiderua si një domosdoshmëri. Në kërkim të kësaj figure, drejtuesit shqiptarë sërish hasën me emrin e Pietro Secchias. Sipas informacioneve të pakonfirmuara që vinin nga legata në Romë, revolucionari i vjetër italian kishte filluar dhe ai të organizonte një grup mbështetësish të vetët, të cilët ishin në pozita marksiste-leniniste⁴⁹. Disa nga komunistët italianë të ftuar në Shqipëri gjatë vitit 1963, si F. Dinucci, A. Quinto e ndonjë tjetër kishin përmendur emrin e Secchias si njeriu që mund të organizonte lëvizjen marksiste-leniniste në Itali⁵⁰.

Gjatë vitit 1963, ministri shqiptar në Romë raportonte se ishte përpjekur disa herë të merrte takim me Secchian, por kishte krijuar përshtypjen se Secchia i shmangej. Angazhimi i tij politik ishte një arsye, por jo e vetmja. Fakti që drejtuesit shqiptarë e kishin adresuar tehun e kritikave drejtpërsëdrejti ndaj Togliattit, dhe veçanërisht pas vizitës së

⁴⁷ *AQSH*, F. 14/AP-str., V. 1962, D. 561, fl. 14. Informacion mbi takimin e zhvilluar mes Jordan Panit dhe Pietro Secchia-s, tetor 1962.

⁴⁸ Enver Hoxha, *Ditar për çështje ndërkombëtare (1961-1963)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 45. “Rreth personalitetit të Sekias, e mërkurë, 17 tetor 1962”.

⁴⁹ *AQSH*, F. 14/AP-str., V. 1963, D. 636, fl. 20. Relacion i ministrit shqiptar në Romë, Jordan Pani për KQ të PPSH, mbi gjendjen në PKI, 19 prill 1962.

⁵⁰ *Po aty*, F. 14/AP-str., V. 1963, D. 893. Informacione të KMMKBJ për KQ të PPSH mbi vizitën e A. Quino-s në Shqipëri, shtator 1963.

këtij të fundit në Jugosllavi e kishin konsideruar si një prej tre krerëve të revizionizmit botëror, së bashku me Hrushovin dhe Titon, e bënte të vështirë për Secchian të kontaktonte hapur me legatën shqiptare në Romë.

Gjatë vjeshtës së vitit 1963, Hysni Kapo i dërgon udhëzime Jordan Panit, që duke shfrytëzuar rastin e përvjetorit të ditëlindjes së Secchias, të shkante ta takonte. Udhëzimet i kujtonin ministrit shqiptar që t'i fliste Secchias mbi vizitën e pritshme të Çu En Lait në Shqipëri.

Biseda që Secchia e Pani zhvilluan në tetor 1963 nuk ndryshonte shumë nga ato gjëra që ishin raportuar edhe në takimet e mëparshme. Secchia vazhdonte në qëndrimet e tij kundërshtuese ndaj udhëheqjes së PKI-së, mendonte ende se Italia duhet të mos e linte mënjanë idenë e revolucionit proletar, por nuk mendonte se duheshin ndërmarrë veprime të pastuduara për të cilat historia kishte treguar se ishin të pasuksesshme. Secchia ripërsëriti kërkesën për të takuar një prej drejtuesve të lartë të PPSH-së.

Menjëherë Hysni Kapo kontaktoi me Manush Myftiun, i cili ndodhej në Vjenë për kurim mjekësor. Në një letër të gjatë, Hysni Kapo vë në dijeni kolegun e tij mbi të gjitha përpjekjet që legata shqiptare në Romë kishte bërë për ta bindur Secchian të ndërmerre një aksion “kundër revizionizmit”. Letra kishte informacione shumë konfidenciale mbi takimet e Enver Hoxhës me delegacione të ndryshme kineze në lidhje me lëvizjen revolucionare marksiste-leniniste, mbi cilat lëvizje kishin shanse për sukses dhe mbi cilat jo, mbi kërkesën e fundit të Hrushovit drejtuar Kinës për ndërprerjen e polemikave, për të cilën kinezët ende nuk kishin kthyer përgjigje, por përgjigjja do të ishte negative⁵¹. Ai e këshilloi kolegun e tij të mos ia bënte me dije materialet Secchias, por t'i përdorte në bisedime nëse vinte momenti. Ai i kujtonte kolegut të mbante parasysh dy çështjet kryesore për të cilat po bisedonte me Secchian: e para ishte situata ndërkombëtare dhe lufta e përgjithshme kundër revizionizmit. E dyta, “të dëgjosh dhe të mësosh çfarë mendon Secchia mbi gjendjen në PKI. Dhe si mendon ai të organizohet lufta kundër revizionizmit në Itali për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Si mendon për grupet revolucionare që kanë dalë sot në Itali? A do të presin shokët përgjegjësa dhe revolucionarë të vjetër italianë që situata të zhvillohet në

⁵¹ *Po aty*, F. 14/AP-str., V. 1964, D. 633, fl. 21. Letër e Hysni Kapos për Manush Myftiun, 25 janar 1964.

spontanitet dhe do i lënë këto forca të shpërndara të veprojnë të çthurura, apo duhet dikush të interesohet për bashkimin, organizimin e tyre dhe të punohet drejt bashkimit të të gjitha forcave të shëndosha komuniste në PKI në luftë kundra revizionizmit”⁵². Në fund të letres, Hysni Kapo e autorizon kolegun e vet ta vërë në dijeni Secchian se “nëse ka preokupacion se puna e lëvizjes duhet ndihmuar se ndryshe ngelet në mes të rrugës edhe këtë çështje e kemi biseduar me shokët kinezë dhe do të zgjidhet. Shih si po shkon për mrekulli puna me shokët belgë. Ata organizuan partinë, zgjodhën KQ dhe në mars bëjnë kongresin. Ata po shkojnë përpara shumë shpejt”⁵³.

Mbi takimin e Secchias me Manush Myftiun të zhvilluar në Romë ende nuk kam gjetur të dhëna dokumentare, por njoftimin që nuk është arritur rezultati i pritshëm e jep Enver Hoxha. Ai në ditarin e tij të marrëdhënieve ndërkombëtare shkruan se: “Në Romë Manysh Myftiu u takua me Secchian. Mendoj se Secchia ka një fond të mirë, e di dhe ka respekt për partinë tonë, është dakord dhe, atje ku s’është dakord me ne, s’është në gjendje të arsyetojë, prandaj me një bisedim të vogël çarmatoset. Ai hapur thotë se Partia Komuniste Italiane është në likuidim e sipër, udhëheqja e saj ka tradhtuar dhe asgjë se lidh me të. Secchia qëndron në parti, pse i vjen keq të largohet apo ta përjashtojnë. Ai ka humbur perspektivën në forcat e shëndosha, nuk shikon ç’bën baza dhe, dashje pa dashje, i frenon njerëzit e mirë të bazës ku ka influencë. Kërkoj ndihmën tonë morale, politike, ideologjike. Me një fjalë, Secchia dëshiron që ta ndihmojmë duke biseduar me të më shumë”⁵⁴.

Muajt në vijim të vitit 1964 sollën ndryshime të rëndësishme si për lëvizjen komuniste në Itali, ashtu dhe për atë ndërkombëtare. Vdekja e Togliatit dhe Testamenti i tij ishin një projekt i vërtetë realist dhe i zbatueshëm për të ardhmen e PKI-së. Largimi nga drejtimi i PKBS-së i Nikita Hrushovit ishte një tjetër moment i rëndësishëm në Botën Komuniste. Pyetjes nëse do të kishte një ridimensionim të qëndrimeve dhe të zbutjes së konflikteve, PPSH-ja iu përgjigj me një jo të prerë. Ajo vijoi të ishte konsekuente “në vijimin e luftës kundër revizionizmit” dhe kërkimit të aleatëve. Gjatë vitit 1964 me Secchian u zhvilluan disa takime në të cilat vijuan përpjekjet për ta bërë pjesë të një lëvizjeje

⁵² *Po aty*, fl. 22.

⁵³ *Po aty*, fl. 25.

⁵⁴ Enver Hoxha, *Ditari i marrëdhënieve ndërkombëtare (1964-1965)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 50.

revolucionare. Përgjigjja e Secchias ishte e njëjtë. Nga 140 veta që përbënin udhëheqjen e PKI-së vetëm 8 mendonin si Secchia. Në këto kushte nuk ishte “e mundur dhe nuk janë konditat për të filluar një sulm kundër vijës së PKI-së në tërësi. Në qoftë se ay me këtë rast do të ngrrejë se kritikrat kundër Hrushovit duhet të çohen deri në fund dhe të gjendet shkak në Kongresin XX dhe në vijën revizioniste, ose të sulmohet vija e PKI si revizioniste kryekëput dhe aty të gjenden shkaqet e qëndrimit të sotëm të udhëheqjes italiane, atëherë do të ndodhte ajo që do të ndodhte [ndodhi] 10 ditë përpara, pra do t’i përjashtonin me lehtësi nga partija dhe këta nuk mund të bëjnë gjë tjetër veçse të formojnë një grup të vogël jashtë partisë që nuk do të ketë ndonjë efekt dhe rëndësi. Ai insistoi dhe njëherë se lufta duhet bërë brenda partisë, jo me ndonjë pretendim të madh për të shtënë partinë në dorë dhe për të ndryshuar sot nga brenda, por sepse është e vetmja mundësi për të bërë diçka sot dhe për të mundur të vazhdosh nesër”⁵⁵. Më 26 nëntor 1964, Enver Hoxha përpilon një sërë udhëzimesh mbi qëndrimin që Jordan Pani duhet të mbante në vijim ndaj revolucionarit italian. Tonet e udhëzimeve shprehin zhgënjimin e drejtuesve të komunistëve shqiptarë ndaj mikut të vjetër. “Atij i është zbutur shpirti revolucionar, shprehet Enver Hoxha në letër, - ai është i mplakur, nuk e ndjen më veten as për aksione revolucionare të theksuara, as të udhëheqë një lëvizje revolucionare qoftë brenda, qoftë jashtë partisë, sidomos jashtë partisë. Ai pra as shpirtërisht, as fizikisht nuk mund ta bëjë këtë”⁵⁶. Por drejtuesit të PPSH-së, i duhej zëri i Secchias brenda në gjirin e PKI-së për të kundërshtuar lidhshimin e saj dhe për të mbajtur gjallë brenda kësaj partie tezat që mbështeste PPSH-ja. Për këtë arsye, Hoxha këshillon të vazhdohen kontaktet me Secchia-n dhe “Ta nxisim në atë që Secchia të punojë në forma legale brenda në parti për të edukuar, për të formuar e kalitur njerëz të rinj, t’i frymëzojë ata, t’i udhëzojë si të studiojnë marksizëm-leninizmin dhe sidomos çfarë duhet të studiojnë. Kjo është një punë e madhe që Secchia mund ta bëjë edhe legalisht, dhe individualisht dhe me grupe, por kurdoherë me dijeninë e udhëheqjes (sepse ai jashtë kësaj rregulle nuk del)”⁵⁷. Sa u takonte grupeve marksiste, Hoxha mendon se është shumë pozitive që Secchia

⁵⁵ *AQSH*, F. 14/AP-str., V. 1964, D. 632, fl. 1. Relacioni i takimit të shokut Sotir me P. Secchia-n, 14 mars 1964.

⁵⁶ *Po aty*, fl. 17. Shënime të Enver Hoxhës në lidhje me bisedimet e shokut Jordan Pani me Pietro Secchia-n, 12 nëntor 1964.

⁵⁷ *Po aty*, fl. 28.

nuk i sulmon hapur dhe për një pjesë të drejtuesve të tyre ka respekt. Ai është shpresëplotë, se grupet marksiste-leniniste do ta tregojnë veten dhe “do të fitojnë besimin e tij”.

Koha tregoi se ishte Secchia që kishte të drejtë për grupet marksiste-leniniste dhe jo Enver Hoxha. Ato u nxitën nga nevoja e PPSH-së dhe PKK-së për t’i treguar opinionit të brendshëm dhe ndërkombëtar mbështetjen në vijën e tyre dogmatike të marksizëm-leninizmit. Jo vetëm grupet marksiste-leniniste në Itali, por edhe në vende të tjera të Evropës Perëndimore nuk arritën të krijojnë qendra solide dhe të fuqishme. Ato mbetën organizata fluide të financuara për të bërë reklamë të një bote që nuk kishte të ardhme dhe zhytej çdo ditë në një varfëri të thellë ekonomike, politike dhe sociale.

S u m m a r y

THE QUEST OF THE ALBANIAN LABOR PARTY TO ATTAIN A GRAVITY CENTER FOR THE MARXIST-LENINIST GROUPS IN ITALY (1963-1966)

After the breaking of relations between the Soviet Union and Albania and the latter’s departure from the Communist Block, the relations of the Albanian Labor Party (ALP) with the communist and labor parties across the world, among which, with the Italian Communist Party (ICP), became quite tense. In the subsequent years, it became obvious that the ICP and ALP were not forthcoming to settle their disputes. While the ALP and ICP were divided in their paths, the Albanian communist leaders started their quest for potential allies among the Italian communists who were dissatisfied with the new political course taken by the ICP. On the one hand, this would contribute in propagating “the successes of the Albanian socialism” in Italy and on the other, would convince the Albanians “of the just struggle of the ALP against revisionism”.

The Marxist and Leninist groups established in Italy in the early 60s’ were inspired and influenced by the ideology of Mao Ce Dun’s China. Although a part of them were impressed by the courage shown by Hoxha in confronting Khrushchev, still for the Italian revolutionary communists the ALP was just an intermediary between them and great China. Even to the most ardent supporters of Albania among the Italian communists, the ALP was a young party, (much younger than ICP) which was leading a small and poor country. However, this was not how Enver Hoxha perceived himself and the ALP at the time. The

documents in the Albanian archives attest that E. Hoxha tried to take the role of the mentor, who would show to European communists, among which the Italians, the way to unification and true Marxist Leninist values. It is the goal of this article to examine the methods used by the ALP's leaders in pinpointing the appropriate Italian Marxist Leninist group which would be used as the core of the future ICP. Furthermore, there will be analyzed the reasons for the appointment of Fosco Dinucci as the head of the new party and the failed attempts of the ALP to persuade Pietro Secchian, the senior Italian communist, to take the lead of the Italian Marxist Leninist groups.